



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

Objekti: Shërbime Organizimi të Eventeve Sportive (CPV – 92622000-7)

Tabela e Përmbajtjes

Terma Reference për Organizim Event Sportiv të organizuara nga "Ekipet Sportive në Shkollë"
"Procedure Prokurimi për Organizimin e "Trajnimi i Trajnereve të Basketbollit nga FIBA në Qarkun e Elbasanit".

Ref: Shërbime Rekreative Kulturore dhe Sportive

1. Rreth KOKSH	2
2. Rreth shërbimit të kërkuar	2
3. Cfarë duam të arrijmë nëpërmjet këtij bashkëpunimi	4
4. Metodologjia dhe plani i punës	3
5. Kualifikimet e nevojshme	3
6. Procesi i aplikimit	4
7. Dorëzimi i ofertave	5
8. Afati i Aplikimit	6
9. Procesi i Vlersimit	6
10. Informacion nëse është përdorur njoftim paraprak	6



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

1. Rreth KOKSH

KOKSH është një organizatë sportive Kombëtare e pavarur, pa qëllim fitimi, e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpike, dhe që funksionon sipas statutit të saj.

KOKSH është pjesë e Lëvizjes Olimpike dhe angazhohet plotësisht të respektojë Kartën Olimpike dhe Kodin Antidoping të Lëvizjes Olimpike, si dhe të jetë konform me vendimet e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar dhe legjislacionin e shtetit Shqiptar.

2. Objekti i shërbimit të kërkuar: Sherbime organizimi te ngjarjeve sportive dhe kulturore.

Për të përmbushur misionin e organizatës dhe për të shpërndarë frymën Olimpike më tej, KOKSH planifikon të organizojë evente sportive, ndeshjet në bashki, ndeshjet në nivel qarku, dhe ndeshjet finale të përmbylljes së kampionatit sipas kalendarit të ndeshjeve dhe sipas nevojave për çdo event që do të organizohet.

Nëpërmjet kësaj thirrje të hapur, KOKSH fton individët/ekipet/kompanitë e interesuara të paraqesin ofertën e tyre sipas specifikimeve të mëposhtme.



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

3. Cfarë duam të arrijmë nëpërmjet këtij bashkëpunimi.

Nr.	Emërtimi	Specifikim Teknik	Njësia	Sasia	Cmim/Njësi	Vlera/Lek	Burimi i Financimit	Kohezgjatja
1	Procedure Prokurimi per Organizimin: “Trajnimi i Trajnereve te Basketbollit nga FIBA ne Qarkun e Elbasanit”	Kerkojme subjekte ku secili prej tyre te mbuloje sherbimet si me poshte: Realizim eventesh te ngjarjeve sportive i cili ofron sherbimet dhe materialet si: -Akomodim -Catering - Sherbim projektioni	Numer sherbimesh	Sherbime	600.000 leke	600.000 leke	Qeveria Shqiptare financim projekti “Ekipet Sportive ne Shkolla”.	1 dite (22-23 Shkurt 2025) Organizimet e eventeve sipas kalendarit te miratuar nga Ekipet Sportive

4. Metodologjia dhe plani i punës

Në kuadër të kësaj procedure prokurimi do të përzgjidhet individ, ekipi apo kompania që paraqet ofertën më të përshtatshme për organizimin e aktivitetit “Trajnimi i Trajnerëve të Basketbollit nga FIBA në Qarkun e Elbasanit”. Organizimi i trajnimit do të zhvillohet në bashkëpunim me përfaqësuesit e FIBA-s.

Plani i punës përfshin:

- **Koordinimin paraprak me FIBA-n**, për përcaktimin e programit të trajnimit, datave dhe pjesëmarrësve.
- **Përgatitjen e ambientit të përshtatshëm** për zhvillimin e trajnimit, duke garantuar të gjitha kushtet teknike dhe logjistike (salla, fushë, pajisje ndihmëse, etj.).
- **Sigurimin e materialeve trajnimi**, përfshirë dokumentacionin, materialet informative, certifikatat dhe logon e projektit sipas kërkesave.
- **Mikpritja dhe akomodimi** i përfaqësuesve të FIBA-s, nëse parashikohet nga kontrata.
- **Monitorimi dhe dokumentimi** i të gjithë procesit të trajnimit për qëllime raportimi dhe transparence.



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

Qëllimi është realizimi i një trajnimit cilësor, me standarde ndërkombëtare, që rrit kapacitetet profesionale të trajnerëve lokalë dhe kontribuon në zhvillimin e sportit të basketbollit në rajon.

5. Kualifikimet e nevojshme

Për të marrë pjesë në këtë procedurë, ofertuesit duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- **Eksperiencë në organizimin e trajnimeve apo eventeve sportive:** Minimum 2 vite përvojë në këtë fushë, e dëshmuar me dokumentacion përkatës.
- **Eksperienca të ngjashme me organizime ndërkombëtare:** Të kenë marrë pjesë ose të kenë organizuar më parë aktivitete në bashkëpunim me organizata ndërkombëtare apo federata sportive.
- **Kapacitete teknike dhe logjistike:** Të jenë të pajisur me infrastrukturën e nevojshme për organizimin e një trajnimit të specializuar sportiv, si edhe të kenë mundësinë për të siguruar mjedise të përshtatshme, pajisje dhe logjistikë mbështetëse.
- **Staf i kualifikuar:** Të kenë staf të specializuar në menaxhimin e aktiviteteve sportive dhe organizimin e trajnimeve.
- **Përputhshmëri me kërkesat ligjore:** Të jenë subjekte të regjistruara dhe aktive, pa detyrime ligjore të pashlyera, dhe të jenë në përputhje me rregullat e prokurimeve publike.

6. Procesi i aplikimit

Për të aplikuar në këtë thirrje kërkohet:

- Oferta Financiare per event.
- NIPT-in e biznesit
- Adresen e sakte.

7. Dorëzimi i ofertave

Për të aplikuar në këtë thirrje ju lutem dërgoni ofertat tuaja në zarf të mbyllur në emër të Sekretarit të Përgjithshëm të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar Z. Gerti Shima, në adresën:

*Tirana Olympic Park
Rr. "Liman Kaba"
Tiranë, Shqipëri
P.O. Box 63*



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

Email: secretary.general@nocalbania.org.al

8. Afati i Aplikimit

- Propozimet duhet të dorëzohen në adresën e mësipërme deri në datë 01.02.2025 jo më vonë se ora 16:00.
- Ofertat duhet të dorëzohen në gjuhën Shqipe.

9. Procesi i Vlerësimit

Vlerësimi do të kryhet sipas sistemit të pikezimit si më poshtë vijon:

Përshkrimi	Pesha në vlerësim %
Eksperiencat e punës/CV e firmës/individit	20%
Eksperience në organizim eventesh të ngjashme.	40%
Staf dhe pajisjet teknike të nevojshme për organizimin e eventit.	40%

10. Informacion nëse është përdorur njoftim paraprak.

Nuk është përdorur njoftim paraprak në lidhje me këtë lloj shërbimi të kërkuar.